

# Raport individual për rezultatet e konsultimit publik

## 1. Titulli i projektvendimit

Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Specializimin Inteligent 2024-2030”.

Ky projektvendim është hartuar, bazuar në urdhrin nr 13, datë 7.2.2023 të Kryeministrit, “Për ngritjen e Komitetit Ndërmintor dhe Ekipit Kombëtar të Strategjisë së Specializimit Inteligent (S3) për organizimin dhe ndjekjen e veprimtarive për hartimin e S3, si dhe koordinimin e procesit të hartimit dhe implementimit të S3”.

## 2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Kohëzgjatja e konsultimeve në kuadër të procesit të Identifikimit përmes Sipërmarrjes (EDP) dhe hartimit të Strategjisë së Specializimit Inteligent (S3) ka përfshirë periudha të ndryshme.

Pikat kryesore dhe periudha e kohëzgjatjes për konsultimet nisin nga tetori 2022 me raundin e parë të aktiviteteve që përfshijnë sektorët si bujqësia, energjia, turizmi, BPO, TIK dhe Prodhimi.

Gjithashtu janë zhvilluar takime dypalëshe me përfaqësues të aktorëve të interesit (qeveria, bizneset, akademika dhe shoqëria civile) të vendeve të rajonit, kufitare me Shqipërinë, si Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi.

Në total, janë organizuar 33 aktivitete kombëtare deri në tetor 2023 dhe 3 aktivitete rajonale (dypalëshe). Gjithashtu janë realizuar 120 takime individuale ose në grup në fazën e draftimit të strategjisë, ku janë diskutuar konkretisht masat dhe aktivitetet që u përfshinë në hartimin e strategjisë. Të gjitha këto procese janë pjesë e draftimit të strategjisë së S3, sepse vetë metodologjia e përdorur është e veçantë duke marrë parasysh skemën bottom-up approach, e cila përfshin të gjitha palët e interesit në proces.

Konsultimi publik në formë elektronike ka nisur më 15.11.2024, me publikimin e draftit të S3 2024-2030 në RENJK (<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/799>). Konsultimi publik është mbyllur më 13.12.2024, sipas afatit që parashikon ligji për njoftimet dhe konsultimet publike.

## 3. Metodatat e konsultimit

Procesi i konsultimeve për hartimin e Strategjisë së Specializimit Inteligent (S3) në Shqipëri përfshiu palët e interesit nga katër helikat:

- biznesi,
- akademika,
- qeveria

- shoqëria civile.

Metodologjia e ndjekur është sipas metodologjisë së sugjeruar nga JRC, e adaptuar nga ekipi kombëtar i S3 për Shqipërinë.

Konsultimet nisën me identifikimin e kujdesshëm të palëve të interesuara që do të kontribuonin në këtë proces. U përfshinë përfaqësues të kompanive kryesore, qendrave kërkimore, universiteteve dhe organizatave publike e private që luanin një rol të rëndësishëm në temat përkatëse.

Metoda e konsultimeve u zhvillua në dy forma kryesore fillestare:

- **tryeza të rrumbullakëta dhe**
- **seminare (workshop-e) kombëtare.**

Tryezat e rrumbullakëta u konceptuan si hapësira për diskutime të lira dhe interaktive. Ato u përdorën për të mbledhur perspektivat fillestare dhe për të identifikuar mundësitë dhe sfidat kryesore në fusha të veçanta. Pjesëmarrësit, të ndarë në grupe të vogla, ndanë mendimet e tyre përmes brainstorming, duke siguruar që çdo aspekt të diskutohej në detaje.

Seminaret (workshop-et) kombëtare, të cilat pasonin tryezat, kishin një qasje më të gjerë dhe shërbenin për të sintetizuar dhe verifikuar gjetjet e nxjerra nga tryezat. Çdo seminar ishte i strukturuar në tri sesione kryesore: Analiza SWOT, formulimi i një vizioni për sektorin dhe përcaktimi i veprimeve politike që duheshin ndjekur. Përfaqësues nga qeveria, biznesi, akademia dhe shoqëria civile bashkëpunuan ngushtë në këto aktivitete, duke shkëmbyer ide dhe duke ndërtuar konsensus.

Në kuadër të përgatitjes për këto aktivitete, pjesëmarrësve u ofroheshin materialet e nevojshme paraprake, duke përfshirë agjendën, dokumente informuese dhe analiza të përmbledhura mbi fushat përkatëse. Këto materiale ishin hartuar nga ekspertët kombëtarë dhe ata ndërkombëtarë për të ndihmuar në orientimin e pjesëmarrësve dhe për të siguruar një diskutim më të strukturuar.

Gjatë këtyre aktiviteteve, pjesëmarrësit ofruan pikëpamje dhe propozime që kontribuan në analizat më të hollësishme të sektorëve. Përfaqësues të qeverisë dhe ekspertë sektorialë lehtësuan këto diskutime dhe mbajtën shënime për të dokumentuar rezultatet.

Pas çdo aktiviteti, të dhënat dhe komentet e mbledhura përpunoheshin dhe përfshiheshin në raportet përfundimtare.

Metoda tjetër e ndjekur përfshin **konsultimin elektronik**, përmes Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, RENJK ku paketa me dokumentet përkatëse qëndroi e publikuar nga data 15.11.2024 deri më 13.12.2024.

Gjatë kësaj periudhe pati 467 shikime dhe nuk pati asnjë koment.

#### **4. Palët e interesit të përfshira**

Palët e interesit të përfshira në procesin e konsultimeve për hartimin e Strategjisë së Specializimit Inteligjent (S3) në Shqipëri ishin të ndara në katër kategori kryesore, të njohura si spiralja e katërfishtë, për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe përfaqësim të gjerë. Këto përfshinin:

##### **1. Bizneset**

- Përfaqësues nga kompani kryesore që operojnë në fushat prioritare si bujqësia, energjia, turizmi, prodhimi dhe teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK)
- Shoqata dhe dhoma të tregtisë që ofrojnë një zë kolektiv për industrinë.
- Biznese të vogla dhe të mesme (BMV), të cilat luajnë një rol kyç në inovacionin dhe zhvillimin e sektorëve.

##### **2. Akademia**

- Universitete dhe qendra kërkimore të specializuara në sektorët përkatës, shkollat e arsimit profesional, agjenci të tjera që lidhen me VET, etj.
- Departamente shkencore dhe teknologjike që ofrojnë ekspertizë dhe mbështetje për analizat e sektorëve.
- Profesorë dhe studiues të njohur në fushat e bujqësisë, energjisë, turizmit, TIK-ut dhe prodhimit.

##### **3. Qeveria**

- Ministri të ndryshme të linjës që mbulojnë sektorët prioritarë, si Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit, Ministria e Kulturës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Ministria e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë, dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen, Ministri i Shtetit për Rininë, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Ministër Shteti për Standartet e Shërbimit
- Agjenci publike dhe institucione rregullatore që mbështesin formulimin dhe zbatimin e politikave.
- Autoritete vendore dhe rajonale që ofrojnë një perspektivë lokale për nevojat dhe mundësitë.

##### **4. Shoqëria civile**

- Organizata joqeveritare (OJQ) të përfshira në zhvillimin e qëndrueshëm, promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe ruajtjen e mjedisit.
- Përfaqësues të grupeve komunitare dhe organizatave profesionale që adresojnë çështje sociale dhe ekonomike të ndërlidhura me fushat prioritare

**5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara**

<b>Çështja e adresuar</b>	<b>Komenti</b>	<b>Palët e interesuara</b>	<b>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</b>	<b>Justifikimi</b>
Copëzimi i tokës dhe pronësia	Mungesa e organizimit dhe fragmentimi i parcelave bujqësore po pengojnë modernizimin dhe zhvillimin e sektorit. Është propozuar rishikimi i politikave për konsolidimin e tokës dhe thjeshtimin e procedurave të pronësisë.	Biznesi, Akademia, Qeveria	I pranuar, pjesërisht	Është njohur nevoja për konsolidimin e tokës, por zbatimi i plotë do të kërkojë ndryshime ligjore dhe reforma afatgjata.
Mungesa e organizimit dhe bashkëpunimit mes fermerëve	Nevojitet krijimi i kooperativave bujqësore dhe promovimi i mekanizmave për bashkëpunim për të rritur produktivitetin dhe fuqizuar zinxhirët e vlerës.	Shoqëria civile, Biznesi, Qeveria	I pranuar	Përpijekjet për të nxitur krijimin e kooperativave janë pjesë e strategjisë, duke përfshirë skema mbështetëse financiare dhe trajnime.
Mungesa e laboratorëve të akredituar për certifikimin e produkteve bujqësore	Është propozuar krijimi i laboratorëve për testimin e cilësisë dhe sigurisë së produkteve për të mbështetur eksportet.	Biznesi, Akademia, Qeveria	I pranuar	Investimet për ngritjen e laboratorëve janë një prioritet për të rritur konkurrencën dhe përputhshmërinë me standardet e eksportit.
Mungesa e financimit dhe aksesit në kredi për fermerët	Subvencionet dhe qasja në kredi me kushte të favorshme janë thelbësore për zhvillimin e sektorit.	Biznesi, Qeveria, Shoqëria civile	I pranuar, pjesërisht	Janë propozuar skema të reja financiare, por zbatimi i plotë varet nga burimet buxhetore dhe bashkëpunimi me institucionet bankare.

Mungesa e aftësive të specializuara	Emigrimi dhe mungesa e njohurive të gjuhëve të huaja, veçanërisht italishtja, po dëmtojnë konkurrencën e sektorit	Biznesi, Akademia, Qeveria	I pranuar	Janë propozuar programe për rikualifikimin e fuqisë punëtore dhe përmirësimin e kurrikulave universitare, veçanërisht për gjuhët e huaja.
Bashkëpunimi midis akademisë dhe biznesit	Kurrikulat universitare nuk përputhen me nevojat e sektorit, dhe praktikat studentore shpesh nuk janë të monitoruara mirë.	Akademia, Biznesi	I pranuar	Është propozuar krijimi i partneriteteve midis universiteteve dhe bizneseve për të përmirësuar trajnimin praktik dhe zhvillimin e kurrikulave të përshtatshme. Është parashikuar rishikimi i kurrikulave dhe teksteve shkollore
Zhvillimi i inovacionit dhe specializimit	Shqipëria duhet të ofrojë shërbime të specializuara dhe të zhvillojë kapacitete unike për të qenë konkurruese në tregun global.	Biznesi, Akademia	I pranuar	Strategjia përfshin investime në teknologji dhe njohuri inovative, si dhe zhvillimin e një plani afatgjatë për transformimin e sektorit.
Angazhimi i diasporës	Mundësitë për tërheqjen e kapitalit njerëzor dhe ekspertizës nga diaspora janë të kufizuara.	Qeveria, Biznesi, Shoqëria civile	I pranuar	Është propozuar krijimi i platformave për bashkëpunim me diasporën dhe promovimi i projekteve për qarkullimin e trurit.
Kostoja e lartë dhe sfidat teknike të ruajtjes së energjisë	Investimet në sistemet e magazinimit dhe ruajtjes janë të kufizuara, duke penguar zhvillimin e energjisë së rinovueshme.	Qeveria, Biznesi	I pranuar, pjesërisht	Kostoja e lartë kërkon financim afatgjatë, ndaj masat fillestare do të fokusohen në mbështetje për projektet pilot dhe

				ndërtimin e infrastrukturës për ruajtjen
Integrimi i energjisë së rinovueshme me sistemet ekzistuese	Ka sfida teknike për integrimin e burimeve të rinovueshme në rrjetin ekzistues.	Qeveria, Biznesi	I pranuar	Strategjia përfshin zhvillimin e sistemeve hibride dhe ndërtimin e infrastrukturës për ndarjen e energjisë në mënyrë efektive.
Nxitja e përdorimit të energjisë së pastër në ndërtesat dhe industrinë	Konsumi i energjisë nga burimet tradicionale mbetet i lartë, duke kërkuar masa për të rritur efikasitetin energjetik.	Shoqëria civile, Qeveria, Biznesi	I pranuar	Janë parashikuar stimuj financiarë për ndërmarrjet dhe individët që përdorin energji të pastër dhe teknologji me efikasitet energjetik.
Nevoja për zhvillimin e infrastrukturës dixhitale	Rrjetet e internetit dhe infrastruktura dixhitale janë të kufizuara, duke penguar zhvillimin e shërbimeve dixhitale.	Qeveria, Biznesi	I pranuar	Është propozuar përmirësimi i rrjeteve të internetit, instalimi i fibrave optike dhe zhvillimi i rrjeteve celulare 5G.
Mungesa e fokusit në specializimin e nënsektorëve të TIK	Sektori i TIK nuk ka qasje të strukturuar për të zhvilluar nënsektorë specifikë si zhvillimi i softuerëve dhe digjitalizimi i të dhënave.	Biznesi, Akademia	I pranuar	Janë planifikuar masa për zhvillimin e nënsektorëve specifikë për të përmirësuar konkurrencën dhe kapacitetin e eksportit.
Nevoja për përmirësimin e sigurisë kibernetike	Sektori përballet me rreziqe të mëdha për sigurinë e të dhënave për shkak të mungesës së investimeve në këtë fushë.	Qeveria, Biznesi	I pranuar, pjesërisht	Strategjia përfshin masa fillestare për forcimin e sigurisë kibernetike, por implementimi do të kërkojë burime të konsiderueshme financiare.
Infrastruktura e papërshtatshme industriale	Aktualisht infrastruktura teknologjike është e kufizuar, me rrjete të vjetruara transporti dhe mungesë zonash	Biznesi, Qeveria	I pranuar	Është propozuar krijimi i zonave teknologjike të specializuara për të ulur kostot dhe për të

	teknologjike të specializuara.			mbështetur zhvillimin e parqeve teknologjike.
Mungesa e kërkimit shkencor	Bashkëpunimi ndërmjet industrisë dhe universiteteve në kërkimin shkencor është i kufizuar dhe mungojnë laboratorët e akredituar.	Akademia, Qeveria, Biznesi	I pranuar	Do të krijohen laboratorë kërkimorë dhe do të rritet financimi për projektet e kërkimit dhe zhvillimit në sektor. Janë parashikuar edhe incentivave për nxitjen e bashkëpunimit mes palëve.
Mungesa e certifikimit dhe testimit të materialeve industriale	Ka mungesë laboratorësh për testimin dhe certifikimin e materialeve, duke çuar në import të lëndëve të para.	Akademia, Qeveria, Biznesi	I pranuar,	Janë planifikuar investime për krijimin e laboratorëve të akredituar për testim dhe certifikim.
Mungesa e organizimit në nënsektorë si përpunimi i drurit dhe tekstileve	Organizimi i dobët pengon zhvillimin e zinxhirit të vlerës dhe aksesin në tregjet ndërkombëtare.	Biznesi, Shoqëria civile, Qeveria	I pranuar	Do të inkurajohet krijimi i shoqatave sektoriale për të organizuar më mirë nënsektorët dhe për të forcuar kapacitetet konkurruese.
Mungesa e diversifikimit të ofertave turistike	Fokusimi kryesor është në turizmin bregdetar, ndërsa potencialet për turizmin malor, kulturor dhe shëndetësor janë të nënshfrytëzuara.	Qeveria, Biznesi, Shoqëria civile	I pranuar	Strategjia përfshin zhvillimin e diversifikimit të ofertave për të promovuar turizmin gjatë gjithë vitit dhe tërheqjen e tregjeve të reja.
Mungesa e standardeve të cilësisë në shërbime	Cilësia e shërbimeve në turizëm është e pabarabartë, dhe shumë operatorë turistikë nuk i përmbushin standardet ndërkombëtare.	Shoqëria civile, Biznesi, Qeveria	I pranuar	Do të zhvillohen programe trajnimi për operatorët turistikë dhe do të vendosen standarde të qarta për shërbimet.

Mungesa e një plani të qëndrueshëm për turizmin rural dhe agroturizmin	Potenciali i turizmit rural dhe agroturizmit është i pashfrytëzuar dhe kërkon mbështetje institucionale.	Biznesi, Shoqëria civile, Qeveria	I pranuar	Strategjia përfshin stimuj për zhvillimin e agroturizmit dhe lidhjen e tij me prodhimin vendas.
Kufizimet në aksesin në financim për bizneset e vogla dhe të mesme në turizëm	Operatorët turistikë të vegjël përballen me sfida të mëdha për të siguruar fonde për zgjerimin e aktiviteteve.	Biznesi, Qeveria	I pranuar, pjesërisht	Janë propozuar skema mbështetëse financiare dhe grante për SME-të në turizëm, por fondet janë të kufizuara.
Zhvillimi i edukimit mjedisor	Promovimi i praktikave miqësore me mjedisin	Akademia	I pranuar	Ndërhyrje në systemin arsimor për të përfshirë kurrikula praktike që lidhen me mjedisin dhe mbrojtjen e tij. Të gjitha aspektet që kanë lidhje me mjedisin janë reflektuar në një sërë masash, me focus te vecantë tek mbrojtja e mjedisit
Mungesa e infrastrukturës për përpunimin e lëndëve të para	Aktualisht, Shqipëria ka mungesë të objekteve dhe pajisjeve të avancuara për përpunimin e lëndëve të para. Kjo pengon përpunimin vendor dhe shton varësinë nga importet.	Biznesi, Qeveria, Akademia	I pranuar	Janë parashikuar investime për krijimin e objekteve të specializuara dhe infrastrukturës për përpunimin e lëndëve të para, duke përfshirë ndihmën financiare dhe grante për bizneset.
Cilësia dhe certifikimi i produkteve industriale	Shqipërisë i mungojnë laboratorët e akredituar për të testuar dhe certifikuar cilësinë e produkteve industriale, duke krijuar pengesa për eksportet.	Akademia, Qeveria, Biznesi	I pranuar	Investimet për ngritjen e laboratorëve të certifikimit dhe standardizimit janë prioritare për të rritur konkurrencën ndërkombëtare të produkteve vendase.



Kufizimet rregullatore për menaxhimin e burimeve natyrore	Politikat aktuale nuk nxisin shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.	Qeveria, Shoqëria civile	I pranuar	Do të rishikohet kuadri rregullativ për të mbështetur shfrytëzimin e qëndrueshëm të lëndëve të para, duke përfshirë mbrojtjen e mjedisit.
Potenciali i pashfrytëzuar i mineraleve dhe lëndëve të para kritike	Shqipëria ka një numër zonash me pasuri minerare të pashfrytëzuara ose të keqmenaxhuara.	Qeveria, Biznesi	I pranuar	Një hartë kombëtare e burimeve minerare do të krijohet për të identifikuar zonat strategjike për shfrytëzim dhe investime të qëndrueshme me metoda të avancuara teknologjike
Nxitja e përdorimit të teknologjive të reja monitorimin e vendburimeve dhe ndotjes mjedisore	Teknologjitë e përpunimit të përdorura janë të vjetruara dhe të paefektshme.	Shoqatat e sektorit, Biznesi	I pranuar	Mbështetje për adoptimin e teknologjive të reja për përpunimin e lëndëve të para është një prioritet për të rritur produktivitetin dhe efikasitetin.